



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 60/16
Prishtinë, më 1.6.2016, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Munguan: Adem Grabovci, Bali Muharremi dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës të ftuar: Agim Krasniqi-zv Ministër i Financave, Valdete Daka – Kryetare e KQZ-së, Enis Halimi - Kryeshef i KQZ së, Miradije Meha –Drejtoreshë e KQZ-së, Florije Kika- U.D. Z.V dretoreshë e AKP-së, Arben Ibrahimimi – U.D ZKF i AKP-së, Lulzim Aliaj- Kryetar i KPMSHCK, Miran Zeneli Drejtori dhe Islam Cakaj nga KPMSHCK.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Lumnije Murati – udheheqëse Divizionit i ZPRK, Fjolla Uka – monitoruese e KDI së, Nexhat Dervishi – Prog Asist i OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Isein, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

R e n d i i d i t ë s :

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 10.5.2016 dhe 11.5.2016;**
- 3. Shqyrtimin i Projektligjit nr.05/L-098 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për rehabilitimin e rrugëve rajonale;**
- 4. Shqyrtimin i Projektligjit nr.05/L-097 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015;**
- 6. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2015;**
- 7. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për vitin 2015;**

8. Shqyrtimi i Kërkesës së Zëvendës Auditorit të Përgjithshëm për caktimin e pagës për Auditorin e Përgjithshëm të Republikës së Kosovës;
9. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë me Raportin plotësues me amendamente të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktura, Tregti dhe Industri;
10. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-081 për Energjinë me Raportin plotësues me amendamente të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktura, Tregti dhe Industri;
11. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike me Raportin plotësues me amendamente të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktura, Tregti dhe Industri;
12. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-082 për Gazin Natyror me Raportin plotësues me amendamente të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktura, Tregti dhe Industri;
13. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-087 për Kundërvajtje dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Madate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
14. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 10.5.2016 dhe 11.5.2016

Kryetari – konstatoi se procesverbalet miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimin i Projektligjit nr.05/L-098 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për rehabilitimin e rrugëve rajonale

Kryetari - Qeveria e Kosovës ka nënshkruar marrëveshjen me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Ka të bëjë me ndertimin e disa rrugëve rajonale, si të rrugës kllokot-gjilan prej 17 kilometra, me përmirsimin e kyqjes së rrugës së Ferizait 5.6 km, me përmirsimin e hyrjes në qytetin e Gjilanit 9.2 metra, me përmirsimin e kyqjes së qytetit të Prizrenit me autostradë.

Agim Krasniqi - kjo marrëveshje ka të bëjë me një kontratë huaje prej 29 milion euro, që është nënshkruar në mes Qeverisë së Kosovës dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për rehabilitimin e rrugëve rajonale. Duhet t'iu bëjë me dije se është brenda klauzolës për investime. Kushtete e kredisë janë të volitshme dhe përfshin një periudhë të kthimit prej 15 viteve, përfshirë një periudhë grejëse prej 3 viteve, norma e interesit do të jetë 1%, plus euroborë që është 6 muaj. Megjithatë se norma është e ndryshueshme, kredia është e leverdishme dhe ekzistone mundësia e fiksimit të normës nga ana e kreditorit. Janë tri projekte të rëndësishme që do të realizohen nga Ministria e Infrastruktura dhe do të jetë pjesë e buxhetit 2017 apo edhe do të jetë në rishikim nëse është e gatshme.

Safete Hadergjonaj- pyeti a ka ndonjë marrëveshje që është ratifikuar dhe që nuk ka filluar ende zbatimin e saj? A ka rrezik me i ratifikue këto marrëveshje, madjes mos me fillue realizimin e këtyre marrëveshjeve?

Agim Krasniqi - në pyetjen e parafolësës, theksoi se duhet me u interesue dhe me marrë informacionet dhe pastaj me e njoftue komisionin.

Kryetari – e kemi fjalën për ratifikimin e marrëveshjes me Bankën Islamike për ndërtimin e rrugëve që kanë kaluar krejtë procedurat por kreditë nuk janë në realizuar, duheni me i shikue e me na informue.

Në bazë të diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin nr.05/L-098 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për rehabilitimin e rrugëve rajonale.

4. Shqyrtimin i Projektligjit nr.05/L-097 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10

Kryetari – marrëveshje është nënshkruar mes Qeverisë së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për rehabilitimin e linjës hekurudhore 10, që është linja hekurudhore është Hani i Elezit - Leshak, që kushton rreth 200 milion euro. Me këtë marrëveshje është paraparë të merren hua prej 42 milion euro, për këtë projekt dhe është një projekt që do të financohet edhe me donacione nga Bashkimi Evropian. Unë konsideroj që është njëra më investimet më të mira që po bëjmë për hekurudhat.

Agim Krasniqi - projekti për rehabilitimin e linjës hekurudhore 10 kap shumë prej 195.5 milion euro duke e përfshirë edhe TVSH-në, prej tyre marrëveshja me Bankën Evropiane Investive është paraparë të merret kredia në vlerë prej 42 milion euro, që i shtohet një kredie që e kemi marrë më heret prej 39.9 milion euro me BERZH-in dhe pjesa tjetër e fondeve për realizimin e këtij projektit është duke u negociuar me BE-në në kuadër të IPA fondeve dhe një pjesë sigurisht do të jetë nga participimi nga buxheti i Kosovës. Kushtet e kredisë janë: periudha e kthimit është 25 vite, me grejësi periudhë prej 4 viteve, norma e interesit është 1%, eurobondi është 0.86%. Pjesa e mjeteve të kredisë do të huazohet nga Kompania Infracos. Kredia do të jetë pjesë e shpenzimeve të klauzolës për investime dhe do të jetë pjesë e buxhetit për vitin 2017.

Këto kontrata kanë një vlerë të madhe, por këto do të ndahen sipas fazave të realizimit është në buxhetet të viteve të ardhshme. Ne kemi dikun 90 apo 100 milion euro në baza vjetore që është sipas klauzolës e për investimeve.

Bardhyl Meta – më sa a e kuptova drejtë, mjetet nga kredia kanë me iu derdhë Infracosit për me menxhë projektin, duke ditur se Infracos menaxhon me një buxhet prej 10,000 eurove, pyetja është e ka kapacitete kjo kompani me menaxhë një kredi me një shumë kaq të lartë?

Agim Krasniqi – Infracos është kompani publike dhe përgjegjëse për realizimin e projektit dhe qeveria mund t'ia nënhuazojë mjetet.

Në bazë të diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin nr.05/L-097 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015

Kryetari - në bazë të nenit 63.10 të Ligjit nr. 03/L-073 Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, ka dërguar raportin vjetor në Kuvend.

Valdete Daka – KQZ ja ka pasur një buxhet të aprovuar për tri programet me shumë prej mbi 5 milion e 300 mijë euro, për 88 zyrtar dhe 11 punëtorë të KQZ-së. Nga kjo shumë 4,200,000 euro janë subvencione e që në fakt nuk janë subvencione, por është fondi për partitë politike, dhe alokohen në buxhetin tonë. Duke përjashtuar këtë shumë, buxheti jonë është shumë i vogël. Nga ky buxhet kemi pasur edhe një shtesë për shkak të mbajtjes së zgjedhjeve për kryetar në komunën e Graçanicës, ku qeveria ka alokuar një mjete shtesë prej mbi 181 mijë euro.

Kryetari - pse drejtoresh nuk e keni paraqit shumën e buxhetit shtesë të ndarë nga qeveria në tabela?

Miradije Meha – theksoi se ne kemi pasur disa herë ndryshime të buxhetit, që përfshihet edhe shuma e ndarë nga qeveria me rastin e zgjedhjeve në Graçanicë, që është here a parë e ndryshimit të buxhetit. Herën e dytë është bërë me rishikim të buxheti ku kemi pasur zvoglim të buxheti në të gjitha kategoritë dhe vetëm ne subvencione nuk ka pas ndryshime. Me rishikim të buxhetit është zvogluar buxheti në paga e meditje për 51,000 euro si rezultat buxheti për paga të zyrtarëve nuk ka mjaftuar dhe me vendim të qeverisë për me mbulue minusin në paga na janë dhënë 30,000 euro buxhet shtesë. Tabelat që i keni ju nuk ka kolonë me i paraqitë ndryshimet që janë bërë me vendim të qeverisë dhe me i mbledh të gjitha këto e jep shumën që është prezantuar në tabela.

Besa Gaxherri – lidhur me listat e votuesve më intereson të dijë a është përfunduar kjo listë apo jo? Sa i përket shpenzimeve të buxhetit në tabelen 4.c shpenzimet e udhëtimit zyrtar dhe shpenzimet e akomodimit jashtë vendit janë mjaftë të larta si të planifikuara po ashtu edhe të shpenzuara, ndërsa ju lutem të na sqaroni se qfarë janë shpenzimet tjera të udhëtimit zyrtar që janë realizuar 9.100 euro dhe keni mbërri me i realizue cent për centë apo 100%? Shpenzimet e telefonisë mobile i keni shfrytëzuar 95%, ndërsa shpenzimet për informim publik i keni 27,194 euro, pse janë këto shpenzime kaq të larta, nuk ju kam parë në media apo nëpër fletushka, që arsyetojnë këto shpenzime? Në fund të tabelës 4.e struktura e pagave ne vitin 2015, shtylla në fund shkruan se duhet të specifikohen pagat dhe shtesat për punëtorët me orar të plot të punës, ju i keni të aprovuar 88 dhe i keni të punësuar 83 punonjës, ndërsa buxhetin për paga dhe meditje nga 708,023 euro sa kanë qenë të miratuara i keni shpenzuar 714,800.36 euro, përkundër asaj që nuk i keni marrë 5 punëtor, një sqarim duhet dhënë për këtë?

Enis Halimi - sa i takon listës së votuesve është një një problematik që kushtëzohet nga ndikimi i akterëve të tjerë si është edhe agjensioni katastral. Është e vërtetë se duket informim publik por është në kontekst të zgjedhjeve në Graçanicë, dhe mjetet janë në atë pjesën që parashihet në kuadër të 181,000 eurove dhe kur bëhen bashkë me buxhetin ajo lexohet e tërësishme. Sa i përket buxhetit për paga, stafi jonë ka angazhim shtesë në kohën e zgjedhjeve që e rrisin shumën e shpenzimeve pagave përtej asaj që është planifikuar.

Besa Gaxherri - unë këtu nuk pajtohem me sqarime, ku decidivisht i keni 88 punëtor të aprovuar, i keni të punësuar 83, mugojnë 5 punëtor, ndërsa shpenzimet i keni më të mëdha.

Kryetari - theksois e ekstra shtesa marrin për proces zgjedhorë dhe ata janë të punësuar të përhershëm.

Enis Halimi - punëtorët janë të përhershëm por punojnë jashtë orarit, prandaj është rritur shuma e shpenzuar në paga.

Miradije Meha - shpenzimet tjera janë të gjitha ato shpenzime që i ka KQZ-ja jashtë shteti. KQZ është e antarësuar si vëzhguese në disa asociacione ndërkombëtare si dhe për vëzhgim të zgjedhjeve në vende të ndryshme, të tjerat janë për biletat e shpenzimet lidhur me udhëtimet.

Besa Gaxherri – shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e akomodimit jashtë vendit i keni me kode të veqanta, por shpenzimet tjera jashtë vendit qfarë janë?

Miradije Meha - shpenzimet tjera jashtë vendit janë biletat e udhëtimit, janë mëditjet dhe pagesa për participim në konferenca.

Fikrim Damka - nga 83 punëtorët që keni të punësuar a marrin të gjithë 10 apo 20 euro kredi të telefonit mobil, apo janë vetëm një pjesë e të punësuarve që marrin?

Enis Halimi – sqaroi se të gjithë të punësuarit marrin mbushje.

Kryetari – theksoi se nuk është në rregull që të gjithë të punësuarit të marrin mbushje, duhet të marrin vetëm ata që e kërkon puna. Prandaj në të ardhën duhet të korigjohet ky shpenzim.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015.

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2015

Kryetari - Agjencia Kosovare e Pronës, ka dërguar raportin vjetor të punës dhe raportin financiar për vitin 2015 në Kuvend. Buxheti përfundimtar i AKP-së për vitin 2015 ka qene 1,768,608€, ndërsa janë shpenzuar 1,713,711€, apo shprehur në përqindje buxheti është realizuar 96.89%. Me rishikim të buxhetit, AKP-ja ka pasur një shkurtim të buxhetit prej 91,158€, ndërsa me vendim të qeverisë buxheti është shkurtuar prej 110,711€

Florie Kika - AKP është një agjenci e pavarur në mandatin e saj për shqyrtimin e kërkesave pronësore dhe private. Agjencia është ballafaquar me sfida të mëdha i cilat i kemi paraqitur edhe në raportin vjetor dhe tri prej tyre janë të nderlidhura me qështjet financiare. Agjencia përveç financimit nga Buxheti të Kosovës ka edhe burimin tjetër të financimit nga ana e donatorëve, mirëpo gjatë viti të kaluar kemi pasur shumë probleme sa i përket pjesës së donacioneve që ka shkaktuar edhe ikjen e stafit profesional. Përveç kësaj sfide tjetër natyrisht është edhe 143 raste që kanë të bëjnë me skemën e kompenzimit. Ne kemi pranuar nga Gjykata Kushtetuese aktgjykimin që kemi qenë të obliguar ti zbatojmë këto obligime mirëpo në mungesë të mjeteve në vlerë prej 3,200,000 euro nuk kemi pasur mundësi ti zbatojmë. Si rezultat i mosmiratimit të Ligjit për Agjencin kosovare për verifikim dhe krahasim të pronës, kemi humbur një fond nga BE-ja.

Sa i përket buxhetit, kërkesa fillestar e agjencisë ka qenë 2,55,2711 euro, në fillim buxheti është miratuar 1,970,477 euro, ndërsa vlera pas rishiqimit të buxhetit është zvogluar buxheti prej 91,158 euro si dhe në dhjetor me vendim të qeverisë është bërë një shkurtim prej 110,710 euro, që në total shpenzimet ka qenë 1,713,711 euro apo 96.89%. Sa i përket kategorive në paga dhe mëditje 100% këtu kemi pas një problem se e di që nuk është një vlerë reale sepse shuma e buxhetit për paga kanë qenë të lejuara 1,300,000 euro, ndërsa në dhjetor ka zbritur në 1,870,000 euro për shkak të shkurtimeve e joqëndrueshmërisë financiare ne kemi humbur stafin rreth 40 punonjës për këtë arsye kjo diferencë ka

rezultuar me këtë ndryshim. Me anë të rishiqimit të buxhetit është reduktuar buxheti në këtë kategori si dhe kemi pasur problem me punësimin e tri pozitave për shkak se ministria e administratës publike nuk ka funksionalizuar sistemin SIMBNJ.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2015.

7. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për vitin 2015

Kryetari - në bazë të nenit 19, të Ligjit nr. 03/L-192, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i ka dërguar Kuvendit raportin vjetor të punës dhe raportin financiar për vitin 2015. Buxheti i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për vitin 2015 ka qene 282,303.00 euro ndërsa pas rishikim buxheti ka qenë në shumë prej 274,441.00 euro. Kurse buxheti i shpenzuar ishte 276,871.52€ apo 99.44%.

Lulzim Aliaj – theksoi se Këshilli edhe në vitin 2015, ka vazhuara me të njejta vështërsi edhe sfidat si në vitin e kaluarë sa i përket buxhetit dhe paisjeve tjera të nevojshme. Përkunder kësaj me gjithë angazhimin e stafit ne kemi arrit me e mbyllur me sukses mandatin tonë që ka të bëjë me mbikqyrjen e legjislacionit për zbatimin civil.

Islam Cakaj – Këshill ka pasur një buxhet prej 282,303.00 euro me rishikim është zvogluar buxheti për 3,862 euro e ky zvoglim ka ndikuar dhe tek pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, shërbime komunale. Nga 222,214 euro sa kanë qenë për paga dhe mëditje janë shpenzuar 221,601.80 euro apo 99.72%, mallra dhe shërbime janë shpenzuar 52,082.48 apo 99.39% , shërbime komunale 3,187.24 euro ose 83.33 % Sa i përket nënkategorisë për mallra dhe shërbime, kemi një tajkalim të por kemi pas servisimin dhe shpenzimet për naftë, për shkak të vëllimit të punës.

Fikrim Damka – theksoi se si në vitin 2014 po ashtu në vitin 2015, shpenzimet për akomodim dhe mëditje janë në rritje?

Besa Gaxherri - pyeti qfarë janë shpenzimet kontraktuese tjera që janë 268%, furnizimet me zyrë 117%. Kemi rritje të shpenzimeve si në vitin 2014, një sqarim për këto tejkalime?

Islam Cakaj – sqaroi se shpenzimet tjera kontaktuese tjera janë shpenzimet për autolarje dhe në mungesë të nënkodit të veqantë janë vendosur në këtë kategori.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për vitin 2015.

8. Shqyrtimi i Kërkesës së Zëvendës Auditorit të Përgjithshëm për caktimin e pagës për Auditorin e Përgjithshëm të Republikës së Kosovës

Kryetari – njoftoi se ka kërkuar informata nga ministria e financave, respektivisht thesari për pagaën bazë të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese dhe propozon që c paga e auditorit të përgjithshëm të jetë ekuivalente me pagën bazë që ka kryetari i gjykatës kushtetuese.

Në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri Kuvendit i paraqet

Propozim-vendim Për caktimin e pagës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës

1. Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës i caktohet paga në shumën prej 1,875.90 euro në muaj.
2. Niveli i pagës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, sipas pikës 1 të këtij Propozim-vendimi, zbatohet duke filluar nga data 30 mars 2016 e deri në miratimin e Ligjit për pagat e funksionarëve të lartë publik.

9. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë me Raportin plotësues me amendamente të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktural, Tregti dhe Industri

Kryetari – theksoi se ne kemi shqyrtuar projektligjin dhe kemi bërë dy amendamentet që cilat janë marrë parasysh me raportin plotësues të komisionit funksional dhe si i tillë projektligji dhe amendamentet e propozuara me raportin plotësues nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë dhe amendamentet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktural, Tregti dhe Industri, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

10. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-081 për Energjinë me Raportin plotësues me amendamente të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktural, Tregti dhe Industri

Kryetari - projektligji dhe amendamentet e propozuara me raportin plotësues të komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.05/L-081 për Energjinë dhe amendamentet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktural, Tregti dhe Industri, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

11. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike me Raportin plotësues me amendamente të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktural, Tregti dhe Industri

Kryetari - projektligji dhe amendamentet e propozuara me raportin plotësues të komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë. Komisioni funksional ka marrë parasysh rekomandimin tonë të bërë në raportin e parë.

Në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike dhe amendamentet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktural, Tregti dhe Industri, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

12. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-082 për Gazin Natyror me Raportin plotësues me amendamente të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktural, Tregti dhe Industri

Kryetari - projektligji dhe amendamentet e propozuara me raportin plotësues të komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.05/L-082 për Gazin Natyror dhe amendamentet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktural, Tregti dhe Industri, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

13. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-087 për Kundërvajtje dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Madate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari - projektligji dhe amendamentet e propozuara nga komisioni funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.05/L-087 për Kundërvajtje dhe amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, Madate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

14. Të ndryshme:

- 14.1. **Kryetari** - ju nftojë se Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka dërguar raportet vjetore financiare për vitin 2015, të përmirësuar sipas kërkesës së komisionit dhe ne si komision do të procedojmë rekomandimet për miratimin e raporteve të këtyre organeve në Kuvend, siç kemi votuar në mbledhjen kur janë shqyrtuar këto raporte.

14.2. **Kryetari** – propozojë që Safete Hadergjonaj dhe Bardhyl Meta, të përbëjnë grupin punues të Komisionit që bashkarisht me administratën e Kuvendit të shqyrtojë kërkesat buxhetore të Kuvendit sipas qarkorës së parë buxhetore 2017/01.

Sipas propozimit të kryetarit të komisionit, Komisioni caktojë grupin punues në përbërjes: Safete Hadergjonaj (kryesuese) dhe Bardhyl Meta (anëtar), për shqyrtimin e kërkesave buxhetore të Kuvendit, sipas qarkorës së parë buxhetore 2017/01 dhe raportimin e tyre në Komision për punën e bërë.

Mbledhja përfundoi në ora 12:15

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani